



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 6037/3 Prot.

Tiranë, më 06.12. 2021

Lënda: Njoftim

OPERATORIT EKONOMIK “HHT HIGH TEST TECH TESTS” SHPK

**Adresa: Rr. “Perlat Rexhepi” Njësia
Bashkiake nr. 5, Kati II, Tiranë.**

Sikurse jeni në dijeni, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) me shkresën Nr.6037/3 Prot., datë 26.10.2021, ka nisur ndaj jush procedimin administrativ në kuadër të kërkesës së paraqitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me objekt: “*Njoftim për operatorin ekonomik “HTT High Tech Tests” Shpk, në lidhje me mospërmbushjen e kontratës me objekt: “Blerje vula plastike për vulosjen e matësave elektrikë”.*

Me shkresën Nr. 6037/4 Prot., datë 23.11.2021, APP ju ka nisur rikujtesën për të dërguar kundërshtimet tuaj në lidhje me këtë çështje, në të njëjtën adresë me të cilën keni marrë dijeni për fillimin e procedimit administrativ, e cila është adresa e dhënë sipas Ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kjo shkresë nuk ka shkuar në destinacionin tuaj dhe është kthyer mbrapsht në datën 26.11.2021, nga Posta Shqiptare.

Në vijim APP, ka rinisur shkresën Nr. 6037/4 Prot., datë 23.11.2021, në datë 26.11.2021, e cila është rikthyer përsëri nga shërbimi postar me justifikimin se, adresa është e panjohur.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik, APP njofton shoqërinë tuaj se, në bazë të parashikimeve të nenit 42 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, rezervoni të drejtën për të paraqitur kundërshtimet tuaja në lidhje me procedimin e nisur, ***brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike***, në të kundërt APP do të vijojë procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Duke ju falënderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

